

**Emri i Lëndës : E Folura në Publik**

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 304	B	6	3	0	0	3.00	6
<b>Lektori dhe orari i konsultimeve</b>			Ramadan Cipuri, PhD				
<b>Asistenti dhe orari i konsultimeve</b>							
<b>Gjuha e kursit</b>			Albanian				
<b>Niveli i lëndës</b>			Bachelor				
<b>Përshkrimi</b>			Sipas filozofisë së kursit, e folura në publik përfshin aftësi të cilat mund të mësohen. Në kurs do të flitet për artin e të folurit në publik dhe do të analizohen të gjithë faktorët që ndikojnë në përgatitjen dhe mbajtjen e një fjalimi të mirë para publikut. Të folurit në publik përfshin çdo lloj komunikimi që ndodh para një grupi njerëzish ose një audience më të gjerë. Që një komunikim i tillë të jetë efikas, duhen njohur mirë elementet që përfshihen gjatë një ndërveprimi të tillë. Analiza e audiencës, puna kërkimore paraprake, zgjedhja e temës, hartimi i fjalimit në mënyrë të strukturuar, mposhtja e etheve të skenës dhe arti i të bindurit janë disa nga çështjet që do të trajtojmë së bashku.				
<b>Objektivat</b>			Në fund të kursit, studenti do të jetë më i familjarizuar me paraqitjen e një ligjërate të mirëargumentuar dhe mirëprezantuar, të përshtatshme me situatën përkatëse. Për të bërë këtë, do të përqëndrohet në disa aspekte: - çfarë do të thotë të jesh një folës dhe dëgjues etik i mesazheve; - identifikimi i elementeve qendrore për një mesazh logjik dhe të mirëorganizuar; - identifikimi dhe prezantimi i llojeve të ndryshme të ligjëratave.				

**Programi i Lëndës**

Java	Tema
<b>1</b>	Njohja me lëndën dhe shpjegim i programit: Prezantimi i programit të lëndës, Njohja me terminologjinë e lëndës.
<b>2</b>	Të folurit në publik • Fuqia e të folurit në publik • Dallimi midis të folurës në publik dhe bashkëbisedimit • E folura në publik dhe të menduarit në mënyrë kritike • Procesi i të folurit në publik • E folura në publik në një botë multikulturore
<b>3</b>	Etika dhe të folurit në publik • Këshilla për një të folur etike në publik • Plagjiatura • Këshilla për dëgjimin etik
<b>4</b>	Dëgjimi • Dëgjimi dhe mendimi kritik • 4 shkaqe të dëgjimit të dobët • Si të bëhesh dëgjues më i mirë
<b>5</b>	Përzgjedhja e temës dhe e qëllimit • Përzgjedhja e temës • Përcaktimi i një qëllimi të përgjithshëm • Përcaktimi i një qëllimi specifik • Thënia e idesë qendrore
<b>6</b>	Analizimi i audiencës • Audienca dhe psikologjia e saj • Analiza demografike e audiencës • Analiza e audiencës sipas situatës • Marrja e informacionit lidhur me audiencën dhe përshtatja me të
<b>7</b>	Organizimi i pjesës qendrore të fjalimit • Çështjet kryesore • Materialet mbështetëse • Lidhjet
<b>8</b>	Provimi Gjysmë-Final
<b>9</b>	Fillimi dhe mbarimi i fjalimit • Hyrja • Konkluzioni
<b>10</b>	Skica e fjalimit • Skica e fjalimit • Skica e mbajtjes së fjalimit • Shembull me koment
<b>11</b>	Përdorimi i gjuhës • Përdorimi i saktë i gjuhës • Gjuha e qartë dhe e gjallë • Përshtatshmëria e gjuhës
<b>12</b>	Mbajtja e fjalimit • Metoda të mbajtjes së fjalimit • Zëri i folësit • Trupi i folësit
<b>13</b>	E folura për të informuar • Llojet e fjalimeve informative, analiza dhe organizimi • Këshilla për të folurën informative
<b>14</b>	E folura për të bindur • Rëndësia e të bindurit (etika dhe të bindurit) • Psikologjia e bindjes së tjetrit • Lloje të ndryshme të fjalimeve bindëse (mbi faktet, vlerat, çështjet politike)

<b>15</b>	E folura në grupe të vogla • Çfarë është një grup i vogël? Përgjegjësitë në një grup të vogël. • Metoda e mendimit reflektues. • Prezantimi i rekomandimeve të grupi.		
<b>16</b>	Provimi Final		
<b>Parakushtet</b>			
<b>Literatura</b>		• Lucas, Stephen E. The Art of Public Speaking, ninth edition. McGraw-Hill International Edition, 2007	
<b>Referenca të tjera</b>		• Leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës në formë narrative, power point etj.	
<b>Punë laborator</b>			
<b>Përdorimi i komp.</b>			
<b>Të tjera</b>			
<b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b>			
<b>1</b>	Studentet do të përcjellin qartë mesazhin nëpërmjet ligjëratave publike		
<b>2</b>	Studentët do të mësojnë teknikën e përcjelljes së mesazhit tek publiku		
<b>Mënyra e Vlerësimit të Lëndës</b>			
<b>Notat e Ndërmjetme</b>		<b>Sasia</b>	<b>Përqindja</b>
Gjysmë finale		1	20
Kuize		4	20
Projekte		0	0
Projekte semestrare		0	0
Punë laborator		0	0
Pjesëmarrja në mësim		1	10
<b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>			<b>50</b>
<b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>			<b>50</b>
<b>Total</b>			100
<b>Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)</b>			
<b>Aktivitetet</b>		<b>Sasia</b>	<b>Kohëzgjatja (orë)</b>
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)		16	3
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)		14	5
Detyra		0	0
Gjysmë finale		1	15
Provimi final		1	17
Të tjera		0	0
<b>Ngarkesa totale e orëve</b>			<b>150</b>
<b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>			<b>6</b>
<b>ECTS</b>			<b>6</b>